



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 758 Prot.

Tiranë, më datë 29.07.2020

VENDIM
Nr. 224, datë 21.07.2020

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 "Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë", neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 "Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale", pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 21.07.2020,

VENDOSI:

1. Miratimin e projektit kërkimor-shkencor në vazhdim «**Forumi Romak-Butrint, 2020**» drejtuar nga Prof. Dr. Luan Përzhita (IA), Prof. Dr. Dhimitër Condi(IA) dhe Prof. Dr. David Hernandez (Universiteti Notre Dame, SHBA), miratuar nga Këshilli Shkencor i Institutit të Arkeologjisë (Akademia e Studimeve Albanologjike), paraqitur nga Instituti i Arkeologjisë në lidhje me veprimtarinë e mëposhtme:
 - Dokumentime tek Shatërvani Romak dhe Ndërtesat Veriore të Forumit;
2. Periudha kohore e kryerjes së punimeve të jetë ajo e nevojshme për kryerjen e tyre, brenda vitit 2020;
3. Në rastet kur parashikohen ndërhyrje në sit/nëntokë dhe evidentohen struktura, duhet të përcaktohen masat që do të merren për konservimin/restaurimin/translokimin e tyre, dhe të shoqërohen me projekt konsolidimi/konservimi/restaurimi pranë IKTK;
4. Të depozitohen pranë IKTK-së, DRTK-së dhe IKRTK-së lista e inventarit të gjetjeve me qëllim grumbullimin, informimin/ regjistrimin sipas rastit dhe ekspozimin e tyre në Muze;
5. Ngarkohet Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore për regjistrimin e këtij Vendimi;
6. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi;
7. Ndaj Vendimit mund të ushtrohet ankim në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR
Arta DOLLANI

KRYETAR

Elva MARGARITI

